

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Arti muzikor* për vitin I (e parë) për arsimin e mesëm në gjimnaz për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *Arti Muzikor për vitin I (e parë)* për arsimin e mesëm - gjimnaz bazohet në qëllimet / rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen njësitë e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të përcaktuara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë në programin e shkurtuar me kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

1. Pasqyra e temave dhe përmbajtjet mësimore

I Tema/Fusha

1. Historia e muzikës 18 (20) orë

Njësitë mësimore

1 - Origjina e muzikës dhe zhvillimi i saj;

2 - Muzika të civilizimet e lashta;

- 3 - Muzika në Mesjetë;
- 4 - Muzikaë mesjetare botërore
- 5 - Muzika e Rilindjes;
- 6 – O. di Laso;
- 7 - J. P. de Palestrina;
- 8 - J. Galus;
- 9 – Paraqitja e operës;
- 10 – **Baroku në muzikë;**
- 11- Instrumentet në barok;
- 12 - K. Monteverdi;
- 13 - A.Vivaldi;
- 14 – Johan Sebastijan Bah;
- 15 – Georg Fridrih Hendl;
- 16 – Klasicizmi në muzikë;
- 17 -K. V. Gluk dhe reformat;
- 18 – Franc Jozef Hajdn;
- 19 – Volfgan Amadeus Mocarti;
- 20 – Ludvig Van Betoven.

Tema/Fusha

2. Teoria muzikore 4 orë

Njësitë mësimore

1 - Mjetet shprehëse të muzikës;

2 - Shkalla tonale – gjinia;

3 - Gjinia tonale paralele (shkallë me dy parashenja);

G-dur – e-moll, D-dur – h- moll. F-dur – d-moll, B-dur – g-moll.

Tema/Fusha

3. Interpretimi vokal 4 orë

Njësitë mësimore

1 – Himni i RMV (F-dur);

2 – Këngë patriotike

3 – Këngë artistike dhe popullore;

4 – Operat e njohura dhe simfonitë (fragmente).

Tema/Fusha

4. Folklor muzikor maqedonas dhe Folklori maqedonas në stilet moderne 6 (8) orë

Njësitë mësimore

- 1 - Karakteristikat e folklorit muzikor në RMV;
- 2 - Metrika, ritmi, melodia e një kënge popullore;
- 3 - Struktura dhe forma e këngëve popullore;
- 4 - Instrumentet popullore në RMV;
- 5 - Tradita popullore e valleve;
- 6 – veprimtarët e parë muzikor maqedonas: Naum Miladinov;
- 7 – Atanas Badev;
- 8 – Folklori në stile moderne.

3.Rekomandimet didaktike

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Arti muzikor për vitin I (e parë) për gjimnaz do të realizohet për 159 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 32 orë mësimore në kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta. Përmbajtjet mësimore mundësojnë integrimin e brendshëm dhe të jashtëm, e cila nënkupton planifikimin integruës ndërmjet temave mësimore në kuadër të programit për artin muzikor, si dhe planifikimin dhe integrimin e jashtëm me lëndët tjera mësimore. Përmbajtjet mësimore nga programi mbeten të njëjta por të radhitura në 32 orë mësimore me ç'rast është bërë shkurtimi prej 4 orë. Për realizimin e përgjithshëm të përmbajtjeve mësimore të temave mësimore, në këtë program është paraparë shkurtimi, përkatësisht integrimi i përmbajtjeve mësimore prej 4 orë mësimore, të bëhet në dy tema. Në temën e parë: „Historia e muzikës” e cila është më e madhja për nga përmbajtja është planifikuar të shkurtohen dy orë mësimore dhe për të njëjtën është planifikuar realizimi i 18 orëve mësimore, përkatësisht në programin e rregullt mësimor. Shkurtimi i 2 (dy) orëve mësimore është paraparë në temën e katërt: „Folklor muzikor maqedonas dhe folklor maqedonas në stile moderne”, dhe parashikohet realizimi i 6 (gjashtë) orëve mësimore, përkatësisht 8 (tetë) orë mësimore në programin e rregullt mësimor.

Përmbajtjet në këto tema janë të integruara nga brenda me njëra-tjetrën, gjë që mundëson performancë dhe realizim shumë më të lehtë të përmbajtjeve të planifikuara mësimore në një numër më të vogël të orëve të planifikuara.

Në këtë program numri i orëve jepet në një orientim i cili i lë hapësirë mësimdhënësit për të shprehur krijimtarinë dhe përshtatjen e tij ndaj kushteve materiale - teknike dhe hapësinore, aktiviteteve të ndryshme dhe përshtatjes së mësimdhënies me situatën e re në të gjithë botën shkaktuar nga virusi Covid -19. Për shkak të kësaj, mësimdhënësit i jepet mundësia, jo vetëm në temat dhe përmbajtjet e parashikuara, të jetë në gjendje të bëjë shkurtimin - pra integrimin, por edhe në temat dhe përmbajtjet e tjera sipas krijimtarisë dhe nevojave të tij.

Nuk ka një qasje të unifikuar në përgatitjen e planeve për realizimin e programeve mësimore për lëndën e arsimit muzikor. E nevojshme është që secili mësimdhënës të kombinojë individualisht përmbajtjen mësimore të temave të njëjta dhe të ndryshme sipas nevojave reale për realizimin e mësimdhënies, në të njëjtën kohë duke marrë parasysh lidhjen logjike midis tyre. Rekomandohet që mësimdhënësit t'i kushtojë vëmendje fushëveprimit të materialit mësimor gjatë realizimit të orës në të cilën ai ka integruar dy ose më shumë përmbajtje mësimore. Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive

mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet / rezultatet e pritura, koncepte të caktuara, metoda dhe aktivitete të përcaktuara në mësimin e rregullt duke marrë parasysh kohëzgjatjen e mësimit prej 35 minutash. Ndjekjen e arritjeve të nxënësve secili mësimdhënës individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të planifikuara për realizim, duke përdorë metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin mësimor të rregullt.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën arti muzikor për vitin I (e parë) në arsimin e mesëm - gjimnaz e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska